



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.596/8 prot

Datë 09.04.2024

V E N D I M

Nr. 359/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2024 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-89077-11-24-2023, me objekt: “*Loti IV– “Blerje artikuj ushqimor kolonial”* me fond limit 54,521,956 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Proinfinit” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, me adresë: Rr. “Barrikadave”, Tiranë.

Ankimues:

“Nelsa” SHPK me NUIS J71601012S, me adresë: Lagjja Qesarakë, Rruga “Tiranë-Dajt”, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: "Proinfinit" SHPK, me NUIS L92204018G dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rr. Tish Daija, Zona Kadastrale 8260 Nr. Pasurie 6/759+3-14, Kompleksi Kika 2, Objekti 7, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.11.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit "*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr.REF-89077-11-24-2023, me objekt: "*Loti IV– "Blerje artikuj ushqimor kolonial"*" me fond limit 54,521,956 lekë pa

TVSH, zhvilluar me datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Tiranë.

II.2. Në datën 23.02.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave si më poshtë vijon:

“3-SH” SHPK	43.955.704 lekë, skualifikuar
“Proinfinit” SHPK	49.971.170 lekë, kualifikuar
“Nelsa” SHPK	50.035.415 lekë, skualifikuar
“Gerti-1987” SHPK	54.434.920 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“2.1 Kriteret e veçanta, pika 2.3.6, operatori ekonomik ka paraqitur në SPE licencë që nuk disponon emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit..”

II.3. Në datën 28.02.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 08.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3880, protokolluar në datën 08.03.2024 me nr. 596/2024 protokollin e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-89077-11-24-2023, me objekt: “*Loti IV– “Blerje artikuj ushqimor kolonial” me fond limit 54,521,956 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Tiranë.*

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Proinfinit” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...] Së pari, në lidhje me skualifikimin e ofertës së shoqërisë tonë me arsyetimin se: “2.1 Kriteret e vecanta, pika 2.3.6, operatori ekonomik ka paraqitur në SPE licencë që nuk disponon emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit”, vlerësojmë se nuk është e bazuar në ligj dhe në fakt dhe rrjedhimisht nuk qëndron

Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, është parashikuar se:

2.3.6 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit:

Për OE/BOE vendas:

Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Për OE/BOE e huaj:

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme për veprimtarinë e ushtruar sipas kërkesës së mësipërme, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës. Në këtë licencë duhet të jetë qartësisht e dallueshme veprimtaria përshkruese sipas këtij kriteri.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm shoqëria jonë ka dorëzuar licencë me kod II.1.A me numër LN-0366-03-2020, datë 30/03/2020 me:

Kategori: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve;

Nënkategori: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve ;

Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz;

Emërtim përshkrues të veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Ambalazhim i frutave dhe perimeve). [...]

Në rastin konkret, sqarojmë se procedura e prokurimit objekt ankimi është një procedurë e cila ka në objektin e saj Furnizimin me produkte ushqimore koloniale të ambalazuara/paketuara”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm shoqëria jonë ka dorëzuar licencë me kod II.1.A me numër LN-0366-03-2020, datë 30/03/2020 me:

Kategori: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve ;

Nënkategori: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve ;

Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz;

Emërtim përshkrues të veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Ambalazhim i frutave dhe perimeve).

Sa më sipër, ashtu sic specifikohet edhe në licencën me numër LN-0366-03-2020 të dorëzuar nga shoqëria jonë, është një licencë e cila ka në fokusin e saj licencimin për veprimtarinë specifike të “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila është praktikisht edhe licenca e kërkuar nga AK në dokumentet standarde të tenderit.

Në rastin konkret kërkojmë të theksojmë se kjo licencë jo vetëm që është e njëjtë me atë të kërkuar në dokumentet e tenderit por në vijim edhe të inspektimeve të kryera nga organet kompetente na rezulton se është licenca e nevojshme për të ushtruar veprimtari si ajo objekt ankimi, pra furnizimin me produkte ushqimore koloniale të ambalazuara/paketuara.

Në lidhje me sa më sipër kërkojmë të theksojmë se të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në inspektimet e kryera pranë subjektit ku ndër të tjera në inspektimet e kryera AKU ka vendosur se:

“Referuar shkresës së ardhur prane DPAKU mbi listën e operatorëve fitues, për procedurën e prokurimit publik, me objekt: Blerje produkte ushqimore me Nr. 1429 Prot., date 12/04/2021, u krye inspektim në subjektin NELSA, i cili ishte pjese e operatoreve fitues per Qarkun e Tiranës dhe u konstatua se: OBU ushtron aktivitetin paketim i frutave dhe perimeve ne nje ambient me infrastrukture dhe kushte te pergjithshme higjieno-sanitare te pershtatshme. Punonjesit jane te pajisur me uniformat e punes dhe librezat shendetesore perkatese. Sherbimi i dezinfektimit kryhet dhe dokumentohet. Disponon analizen bakteriologjike te ujit te rrjetit.

Pajisjet per paketimin e ushqimeve, frutave dhe perimeve jane te pershtashme dhe per paketimin e tyre perdor kuti kartoni dhe vasketa.

Kushtet per ruajtjen e produkteve ushqimore te cilat ruhen ne temperature ambjenti jane te pershtatshme. Mjetet e transportit jane te pershtatshme per transportin e produkteve ne temperature ambjenti. Disponon ambjent te vecante per ambalazhin. Implementon planin e vetekontrollit HACCP. OBU eshte pajisur me licence nr. LC-8211-03-2020 ne daten 21.03.2020. Referuar nenit 47 te Ligjit nr.10433 date 16.06.2011 Per Inspektimin ne RSH inspektimi i kryer eshte i plote. (bashkëngjitur do të gjeni procesverbalin e inspektimit nr. AKU-TR-2021-002518-2 , datë 11.05.2021).

Gjithashtu në inspektimin Nr. AKU-TR-2023-007410ñ2, datë 02.11.2023 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në vendimin për inspektimin e kryer citon se : Nga kontrolli i ushtruar në subjekt në momentin e kontrollit rezultoi që subjekti ushtron aktivitetin si magazine ushqimore temperature ambjenti dhe fruta perime, kushtet higjieno sanitare janë të mira, personeli është i pajisur me librezat shëndetësore dhe uniforme, disponon sistemin e gjurmueshmerisë, disponon raport analizat e produkteve, disponon planin hacp dhe zbatohet, ka kryer dezinfektimin e ambjenteve, tavolinat e punës dhe mjetet e punës janë të përshtatshme, produktet ushqimore janë brënda afatit të përdorimit dhe shoqerohen me raport analizë, dispononon lavaman me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë. Bashkëngjitur foto në sistemin online e-inspektimi. Referuar nenit 47 te ligjit 10433 dt 16.06.2011 per inspektimin ne RSH nga kontrolli i ushtruar ne subjekt nuk u konstatuan shkelje te kerkesave ligjore, ky vendim eshte perfundimtar dhe i behet me dije subjektit te inspektimit”.

Në rastin konkret kërkojmë të theksojmë se shoqëria jonë ka dorëzuar në SPE së bashku me dokumentacionin e kërkuar edhe procesverbalin Nr.AKU-TR-2023-007410ñ2, datë 02.11.2023 nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në mënyrë të tillë që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vërtetojë jo vetëm disponimin e kësaj licence për ushtrimin e këtij aktiviteti por gjithashtu edhe fakti i ushtrimit të aktivitetit në përputhje me kushtet dhe dispozitat ligjore në fuqi. Sa më sipër, theksojmë se ashtu si specifikohet edhe në licencën me numër LN-0366-03-2020 të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nelsa” Shpk në SPE, kjo është një licencë e cila ka në fokusin e saj licencimin për ushtrimin e veprimtarisë specifike të “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, pra duke përfshirë edhe veprimtarinë e furnizimit me produkte ushqimore koloniale të ambalazuara/paketuara që kërkohet në rastin konkret.

Sa më sipër, vlerësojmë arsyeja e skualifikimit nuk është e bazuar në ligj dhe në fakt dhe rrjedhimisht nuk qëndron.

II. Në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Proinfinit” Shpk, bazuar në hulumtimet e kryera, vlerësojmë se ky i fundit nuk duhet të ishte kualifikuar pasi nuk përmbush kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit dhe se kualifikimi i këtij të fundit është kryer në kundërshtim me ligjin “Për prokurimin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Së pari, në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” parashikohet se: “Ofertuesi duhet të paraqesë: “a. Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”. [...]

Në rastin konkret kërkojmë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Proinfinit” Shpk për të vërtetuar deklaratimet e bëra në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” për cdo deklaram që përmban ky vetëdeklarim, pasi kemi dyshime të arsyeshme se ky operator ekonomik nuk përmbush kriteret e kualifikimit.

Së dyti, në shtojcën 7 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” parashikohet se:

2.3.8 OE duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare sipas kërkesave në specifikimet teknike, për secilin prej artikujve objekt i këtij loti.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një mostër për cdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor dhe dëshmime të testimeve zyrtare të dorëzuara në SPE.

Mostrat e kërkuara do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPCK me adresë Rr. E Barrikadave, Cerdhja nr.1 Tirane. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etikete e cila të përmbajë elementet: mostër, emri i artikullit, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Mungesa e mostres është kusht skualifikues. [...]

Në rastin konkret pasi morëm në shqyrtim dokumentet e tenderit, shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe Grafikut të lëvrimit”, meqënëse shoqëria jonë ishte prezente në momentin e dorëzimit të mostrave, kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Proinfinit” Shpk nuk përmbush kërkesat e mësipërme, **pasi rezultatet e raport analizave të dorëzuara nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit si dhe nuk bëhet lidhja dhe nuk vërtetohet se raport analizat e dorëzuar korrespondojnë me mostrat e dorëzuara nga ky operator ekonomik.** Në lidhje me sa më sipër, kërkojmë të verifikohet përmbushja ose jo e specifikimeve teknike të parashikuara në DST, bazuar në raport analizat, të dorëzuara në SPE nga operatori ekonomik “Proinfinit” Shpk si dhe të verifikohet përputhshmëria e raport analizave të dorëzuara në SPE me mostrat e dorëzuara në ditën e hapjes së ofertave, pasi kemi dyshime të arsyeshme jo vetëm që ky operator ekonomik nuk përmbush të gjitha specifikimet teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi por në të njëjtën kohë nuk vërtetohet që raport analizat e dorëzuara përputhen dhe korrespondojnë me mostrat e dorëzuara.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 596/2, datë 09.03.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 596 prot., datë 08.03.2024, si dhe kriteret të cilat operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Proinfinit” SHPK.

II.6. Në datën 20.03.2024, është protokolluar në KPP me nr. 596/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 387/6 prot., datë 19.03.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje mbi ankesën e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK, në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2024”, konkretisht loti IV “Blerje artikuj ushqimore kolonial (ambalazhuar/paketuar)”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, bashkëngjitur Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me datë

19.03.2024. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK është refuzuar si më poshtë vijon:

“[...]

➤ Në lidhje me pretendimin e OE se: “Në rastin konkret, sqarojmë se procedura e prokurimit objekt ankimi është një procedurë e cila ka në objektin e saj Furnizimin me produkte ushqimore koloniale të ambalazuara/paketuara”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm shoqëria jonë ka dorëzuar licencë me kod II.1.A me numër LN-0366-03-2020, datë 30/03/2020 me: Kategori: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve; Nënkategori: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve ;

Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Emërtim përshkrues të veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Ambalazhim i frutave dhe perimeve).

Sa më sipër, ashtu sic specifikohet edhe në licencën me numër LN-0366-03-2020 të dorëzuar nga shoqëria jonë, është një licencë e cila ka në fokusin e saj licencimin për veprimtarinë specifike të “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila është praktikisht edhe licenca e kërkuar nga AK në dokumentet standarde të tenderit.

Në rastin konkret kërkojmë të theksojmë se kjo licencë jo vetëm që është e njëjtë me atë të kërkuar në dokumentet e tenderit por në vijim edhe të inspektimeve të kryera nga organet kompetente na rezulton se është licenca e nevojshme për të ushtruar veprimtari si ajo objekt ankimi, pra furnizimin me produkte ushqimore koloniale të ambalazuara/paketuara.” sqarojmë se procedura e prokurimit objekt ankimi është një procedurë e ndarë në lote, pikërisht për këtë arsye AK në përcaktimin e kriterëve në DST ka specifikuar se OE duhet të disponojë licencë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit. Veprimtaria përshkruese e licencës së depozituar nga OE ankimes rezulton të jetë ambalazhim i frutave dhe perimeve, ndërkohë që loti për të cilin ka ofertuar është “Blerje e artikujve ushqimore kolonial (ambalazhuar/paketuar), konkretisht sipas shtojcës 6 të DST “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, ky lot përmban artikuj si: miell, oriz, makarona, sheqer, kripë trahana, vaj ... etj. Ndërkohë që në lotin V të kësaj procedure kërkohen fruta (mollë, portokalle, banane ... etj) dhe perime (bizele, karrota, patate ... etj). Rrjedhimisht konsiderojmë se licenca për frutat dhe perimet nuk i përket këtij loti.

➤ Përsa i përket pretendimit se: “Referuar shkresës së ardhur prane DPAKU mbi listën e ushqimeve, frutave dhe perimeve e operatorëve fitues, për procedurën e prokurimit publik, me objekt: Blerje produkte ushqimore me Nr. 1429 Prot., date 12/04/2021, u krye inspektim në subjektin NELSA, i cili ishte pjese e operatoreve fitues per Qarkun e Tiranës dhe u konstatua se: OBU ushtron aktivitetin paketim i frutave dhe perimeve ne nje ambient me infrastrukture dhe kushte te pergjithshme higjiene-sanitare te pershtatshme. Punonjesit jane te pajisur me uniformat e punes dhe librezat shendetesore perkatese. Sherbimi i dezinfektimit kryhet dhe dokumentohet. Disponon analizen bakteriologjike te ujit te rrjetit. Pajisjet per paketimin jane te pershtatshme dhe per paketimin e tyre perdor kuti kartoni dhe vasketa. ... Në rastin konkret kërkojmë të theksojmë se shoqëria jonë ka dorëzuar në SPE së bashku me dokumentacionin e kërkuar edhe procesverbalin Nr.AKU-TR-2023-007410n2, datë 02.11.2023 nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në mënyrë të tillë që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vërtetojë jo vetëm disponimin e kësaj licence për ushtrimin e këtij aktiviteti por gjithashtu edhe fakti i

ushtrimit të aktivitetit në përputhje me kushtet dhe dispozitat ligjore në fuqi. Sa më sipër, theksojmë se ashtu si specifikohet edhe në licencën me numër LN-0366-03-2020 të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nelsa” Shpk në SPE, kjo është një licencë e cila ka në fokusin e saj licencimin për ushtrimin e veprimtarisë specifike të “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, pra duke përfshirë edhe veprimtarinë e furnizimit me produkte ushqimore koloniale të ambalazhuara/paketuara që kërkohet në rastin konkret.” sqarojmë se autoriteti ynë kontraktor nuk zotëron kompetencat dhe nuk ka tagër të tij, gjykimin mbi plotësimin e kushteve higjieno-sanitare apo cdo kushti tjetër teknik të vendosur nga organet kompetente në lidhje me licencimin apo inspektimin e këtyre licencave dhe nuk gjykon mbi to. Në argumentat e paraqitura nga OE thekson faktin se DPAKU ka konstatuar se OE ushtron aktivitetin paketim i frutave dhe perimeve në një ambient me infrastrukturë dhe kushte të përgjithshme higjieno-sanitare të përshtatshme, AK rithekson se ky nuk është aktivitet i përshtatshëm për këtë lot. KVO në fazën e vlerësimit të ofertave nuk vlerëson se veprimtaria e ushtruar është në përputhje me kushtet ligjore në fuqi. Në lidhje me këtë përcaktim është vendosur kriteri 2.3.7 i cili përcakton se OE duhet të paraqesë një vetëdeklarim ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore, dhe OE i klasifikuar i pari përpara shpalljes së Njoftimit të Fituesit (paraprak) depoziton dokumentin përkatës provues. Për sa më sipër, duke cituar inspektimin e kryer nga organet kompetente OE ka ritheksuar se kryen aktivitetin e paketimit të fruta perimeve, konform legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu sjellim në vëmendje të OE, se në të njëjtën procedurë prokurimi të vitit 2022 konkretisht procedura “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, “Marrëveshje kuadër me afat 12 mujor” [...] me objekt: “Blerje ushqime për vitin 2022, ndarë në 5 lote”, konkretisht loti IV, me objekt: “Blerje artikuj ushqimore”, ndër të tjera është skualifikuar për të njëjtën arsye.

KPP, për ekonomi të shqyrtimit administrativ, nuk e shqyrtoi skualifikimin për këtë kriter. Shoqëria “Nelsa” SHPK iu drejtua Gjykatës Administrative të Apelit dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin e datës 12.03.2024 u rrëzua kërkespadija e ngritur nga shoqëria “Nelsa” SHPK. Pjesë e objektit të gjyqimit ishte edhe fakti që ky OE ishte skualifikuar në lotin “Blerje artikuj ushqimorë” për shkak të licencës me veprimtari përshkruese “Ambalazhim i frutave dhe perimeve”.

➤ Për sa i përket pretendimit se: “[...] kërkojmë verifikimin e dokumentacionit e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Proinfinit” Shpk për të vërtetuar deklaratimet e bëra në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” për cdo deklaram që përmban ky vetëdeklarim, pasi kemi dyshime të arsyeshme se ky operator ekonomik nuk përmbush kriteret e kualifikimit”, sqarojmë se referuar nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, OE i klasifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur në SPE formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në datën 23.02.2024 KVO ka kryer klasifikimin në SPE dhe ka njoftuar OE “Proinfinit” shpk, klasifikuar i pari, për të dorëzuar dokumentet provuese. Në datën 26.02.2024 OE ka paraqitur fizikisht pranë AK të gjithë dokumentacionin e depozituar në SPE së bashku me dokumentet provuese për vetëdeklarim, në bështetje të nenit 27, pika 6 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021. Konkretisht: [...].

➤ Për sa i përket pretendimit se: “[...]”, meqënëse shoqëria jonë ishte prezente në momentin e dorëzimit të mostrave, kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Proinfinit” Shpk nuk përmbush kërkesat e mësipërme, pasi rezultatet e raport analizave të dorëzuara nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet standarde të tenderit si dhe nuk bëhet lidhja dhe nuk vërtetohet se raport analizat e dorëzuar korrespondojnë me mostrat e dorëzuara nga ky operator ekonomik. Në lidhje me sa më sipër, kërkojmë të verifikohet përmbushja ose jo e specifikimeve teknike të parashikuara në DST, bazuar në raport analizat, të dorëzuara në SPE nga operatori ekonomik “Proinfinit” Shpk si dhe të verifikohet përputhshmëria i raport analizave të dorëzuara në SPE me mostrat e dorëzuara në ditën e hapjes së ofertave, pasi kemi dyshime të arsyeshme jo vetëm që ky operator ekonomik nuk përmbush të gjitha specifikimet teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi por në të njëjtën kohë nuk vërtetohet që raport analizat e dorëzuara përputhen dhe korrespondojnë me mostrat e dorëzuara” sqarojmë se në përmbushje të këtij kriteri OE ka paraqitur në SPE dhe ka depozituar pranë AK analizat si më poshtë:

Certifikatë analize 12.353_23 + Certifikatë analize 34.139_23 + Certifikatë analize 13.353_23 + Certifikatë analize 14.353_23 + Certifikatë analize 1.349_23 + Certifikatë analize 9.279_23 + Certifikatë analize 1.277_23 + Certifikatë analize 17.353_23 + Certifikatë analize 15.353_23 + Certifikatë analize 23.353_23 + Certifikatë analize 4.254_23 + Certifikatë analize 3.254_23 + + Certifikatë analize 11.353_23 + Certifikatë analize 10.353_23 + Certifikatë analize 9.353_23 + Certifikatë analize 16.353_23 + Certifikatë analize 18.353_23 + Certifikatë analize 19.353_23 + Certifikatë analize 20.353_23 + Certifikatë analize 21.353_23 + Certifikatë analize 22.353_23 + Certifikatë analize 8.353_23 + Certifikatë analize 16.353_23 (origjinale 23 fletë).

Në certifikat analizat e paraqitura, të listuara më lart, janë përcaktuar emri i produktit, konfeksioni, data e skadencës si dhe të gjithë treguesit e analizuar, të cilët janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Në procesverbalet e administrimit të mostrave janë pasqyruar të gjitha të dhënat mbi mostrat e paraqitura nga OE pjesëmarrës, konkretisht nga OE “Proinfinit” SHPK për lotin IV. Në procesverbalin e sipërcituar për secilin artikull përshkruhen: Lloji i produktit, marka tregtare, prodhuesi, konfeksioni, ambalazhimi dhe data e skadencës. Gjithashtu sqarojmë senga ballafaqimi i certifikat analizave të depozituara në SPE dhe produkteve të paraqitura si mostër, u konkludua se të dhënat e produkteve në certifikat- analiza lidhen qartë me të dhënat e produkteve të paraqitura si mostër.”

II.7. Në datën 21.03.2024, nëpërmjet shkresës me nr.596/4 prot., me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të sjellë në KPP, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, shoqëruar me dokumentacionin e plotë të paraqitur nga shoqëria “Proinfinit” SHPK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të njehsuara me vulën e institucionit tuaj, si dhe mostrat e paraqitura nga ky i fundit.

II.8. Në datën 26.03.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 596/5 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 387/8 prot., datë 26.03.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje”, bashkëngjitur dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Proinfinit” SHPK në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të njehsuara me vulën e institucionit; procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave, si dhe mostrat e paraqitura nga shoqëria objekt - ankimimi.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit, dokumentacionit dhe mostrat e paraqitura nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK, me arsyen se: *“2.1 Kriteret e veçanta, pika 2.3.6, operatori ekonomik ka paraqitur në SPE licencë që nuk disponon emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit..”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 2.3.6 *“Kapaciteti teknik”*, përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit:

Për OE/BOE vendas:

Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Për OE/BOE e huaj:

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme për veprimtarinë e ushtruar sipas kërkesës së mësipërme, të leshuar nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës. Në këtë licencë duhet të jetë qartësisht e dallueshme veprimtaria përshkruese sipas këtij kriteri.

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, është parashikuar si vijon:

11. Vaj Ulliri i virgjër

STASH 1402:2004

Ligji nr. Nr. 87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 21.3.2017 Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”, VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”

Vaj Ulliri i Virgjër

"Vaj ulliri i virgjër" është vaji i fituar nga përpunimi i frutit të ullirit nëpërmjet proceseve mekanike dhe fizike, silarja, presimi, centrifugimi dhe që nuk i nënshtrohet asnjë manipulimi dhe asnjë trajtimi tjetër.

Vaji i ullirit i virgjër është vaji i ulliri i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 2 gramë për 100 gramë dhe ka karakteristika si më poshtë:

Treguesit organo leptikë:

- Pamja e jashtme të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullirë.
- Ngjyra të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile.
- Era dhe shija karakteristike e vajit të ullirit. Nuk duhet të përmbaje lëndë të huaja. Nuk duhet të jetë i rafinuar.
- Ambalazhimi në shishe qelqi ose plastike 0,5 - 1 litër, të cilat plotësojnë standardet e përcaktuara dhe ligjet në fuqi.
- Nuk duhet të jetë i përzier me vajra të tjera dhe konservantë.

Treguesit e tjerë fiziko kimik (analiza fiziko-kimike):

- Aciditeti i lirë në acid oleik, gramë/100 gramë, në % $\leq 2\%$
- Vlera i peroksive ≤ 20 mek O_2/kg
- Koeficienti i perthithjes ultraviolett (UV)- ($K^{1\%}_{1cm}$)

$$*K_{(232)} \leq 2.60$$

$$*K_{(270)} \leq 0.25$$

$$*Delta K \leq 0.01$$

- Lagështia dhe lëndë flurore në % m/m $\leq 0.2\%$
- Papastërti të patreteshme - % m/m ≤ 0.1
- Gjurmë metalesh mg/kg
 - Hekur ≤ 3.0
 - Bakër ≤ 0.1
- Lëndët e pasaponifikueshme – g/kg ≤ 15
- Numri i Jodit (Sipas Eijs) 75-94

Etiketimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Masa neto ose vëllimi i produktit.

Data e skadimit.

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.

Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

12. Fasule

STASH 1723/87

VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”

Fasule.

Treguesit Organo-leptikë

Pamja e jashtme: Kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale, e rrumbullakët, e gjatë etj) me gjatësi 8 – 13mm.

Ngjyra e bardhë.

Era dhe shija: Pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo ere tjetër të huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

Lagështia jo më shumë se 15%

Lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%.

Kokrra të thyera jo më shumë se 13%.

Përzierje kokrrash jo më shumë se 2.2%.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Infeksione ose dëmtime nga insektet nuk lejohen.

Ambalazhimi:

Ambalazhimi i paketuar me peshë 1 kg.

Etiketimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Masa neto produktit.

Data e skadimit.

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

13. Makarona

STASH 1170/87

VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”

Makarona të gjata.

dhe

Makarona të vogla.

Treguesit “Organiko-Leptikë”

Pamja e jashtme: Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër.
Pas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.

Ngjyra: E bardhë me nuancë të verdhë.

Era dhe shija: E mirë karakteristike e makaronave pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

Lagështia jo me shume se 13%.

Aciditeti: Acid sulfuric jo më shumë se 0,16%.

Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 here.

Insekte dhe dëmtues të tjere nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Makaronat të jenë të ambalazuara me qese polietileni nga 0.5 - 1 kg, të mos jenë të miellëzuara, të tregohet koha e zierjes dhe tregues të tjerë:

Etiketimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Masa neto

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shitesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e ciladuhettë përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

RaportAnalizatduhettëparaqitennë original, osefotokopjetënoterizuara.

14. Reçel

STASH 1477/87

Urdhëri nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,

VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”

1. Reçel kumbulle

dhe

2. Reçel qershie

Treguesit cilësorë të reçelit:

Pamja e ngjyra: E mirë, me fruta me ngjyrë të njëllojtë, karakteristike e llojit, pa bërthamë dhe farë.

Shija dhe era: me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamelizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Cilesia e reçelit duhet të jete ne perputhje me lenden e pare qe eshte perdour per prodhim dhe sipas kerkese se Autoritetit kontraktor.

Konsistenca:

Masë e njëllojtë, viskoze deri xhelatinoze me fruta me zierje normale.

Treguesit fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

1.Lëndët e thata sipas refraktometrit në 20⁰C jo më pak se 65 %

2.Sheqer gjithsej (sheqer saharoz dhe i vetë frutit) jo më pak se 55 %

3.Aciditeti i shprehur në acit tartik, jo më shumë se 1.3%,

4. Përmbajtja e kriprave të metaleve të rënda në mg/kg produkt, jo më shumë se:

Kallaji 100

Bakri 10

Zinku 10

Plumbi 0.1

Arseniku 0.2

5. Shenja myku dhe fermentimi nuk lejohen

6. Lëndë të huaja nuk lejohen.

RaportAnaliza mikrobiologjike:

- E. Coli

Ambalazhimi:

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.6. Në nenin 40 pika 5 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.7. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orientuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emeritimi i veprimtarise(ve) specifike te licencuara sqarohet se: a) Ketu vendoset emeritimi i veprimtarise specike kur kjo eshte e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kerkuar te ushtroje me shume se nje veprimtari specifike, ketu vendosen emeritimet e te gjitha atyre veprimtarive specifike qe ka kerkuar te licencohen. c) Nese keto shenime kerkojne me shume se 250 karaktere atehere vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkelidhur Nr.....”

III.1.8. Në nenin 3, pika 16, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Faza të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes” është çdo fazë, përfshirë importet dhe lëndët e para për prodhimin e ushqimeve, përfshirë ruajtjen, transportin, shitjen ose furnizimin e konsumatorit përfundimtar dhe, në mënyrë të ngjashme, importimin, prodhimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, shitjen dhe furnizimin e ushqimeve për kafshë”.

III.1.9. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.

III.1.10. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, parashikohet shprehimisht:

Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4 1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare

6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.

III.1.11. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të

Përbashkëta”, Fusha II “*Ushqimi dhe Shëndeti*”, Kategoria II.1 “*Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve*”, parashikohet shprehimisht:

1. *Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

2. *Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:*

- a) *“Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;*
- b) *“Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;*
- c) *“Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.*

3. *Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

4. *Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.*

III.1.12. Në nenin 17, “*Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet*” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “*Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë*”, parashikohet shprehimisht se:

1. *Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.*

2. *Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.*

3. *Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:*

- a) *emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;*
- b) *llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;*
- c) *të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën;*
- ç) *vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimin apo përdorimit të së mirës;*
- d) *të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;*
- dh) *deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);*
- e) *deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;*
- ë) *adresën për komunikim;*
- f) *listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.*

4. *QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.*

5. *Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.*

III.1.13. Në nenin 23, “*Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes*” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “*Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë*”, parashikohet shprehimisht se:

1. *Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.*

2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:

a) emrin dhe stemën e QKL-së;

b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;

c) të dhënat për identifikimin e titullarit;

ç) llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;

d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë);

dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimin apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka);

e) afatin e vlefshmërisë;

ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;

f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë;

g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

III.1.14. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, rezulton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht se **Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit: Për OE/BOE vendas: Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme: Kategoria:II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. Për OE/BOE e huaj: Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme për veprimtarinë e ushtruar sipas kërkesës së mësipërme, të lëshuar nga**

autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës. Në këtë licencë duhet të jetë qartësisht e dallueshme veprimtaria përshkruese sipas këtij kriteri.

Referuar proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton, se autoriteti kontraktor për kriterin e mësipërm ka arsyetuar shprehimisht: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.*

Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se objekti i prokurimit të procedurës objekt-ankimi është **Blerje artikuj ushqimore kolonialë**, dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licencë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas lotit të objektit, që në rastin konkret është blerje artikuj ushqimore kolonialë, të ambalazhuar/paketuar, ku përfshihen artikujt si vijon: Vaj ulliri i virgjër, Fasule, Makarona të gjata, Makarona të vogla, Reçel qershie, Reçel kumbllë, Trahana, Sheqer, Oriz, Miell gruri, Miell misri, Miell orizi, Thjerrëza, Tërshërë, Drithëra për fëmijë, Kripë, Qiqra, Vanilje, Pluhur pjekje, Kanellë, Arra moskati dhe Rigon i tharë.

Në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. **Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës**”. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar, se kërkesat e vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit duhet të jenë në proporcion me objektin e kontratës. Nga ana tjetër, vetë autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me këtë kriter ka parashikuar, se kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit që në rastin në shqyrtim është artikuj ushqimore kolonialë, të ambalazhuar/paketuar, me kategorinë II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Në rastin konkret, objekti i kontratës objekt - prokurimi është blerje artikuj ushqimore kolonialë, ndërkohë referuar licencës së dorëzuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK, rezulton, se ky i fundit disponon licencë me veprimtari specifike ambalazhim i frutave dhe perimeve. Në ankesën e tij operatori ekonomik “Nelsa” SHPK pretendon se: *ka dorëzuar licencë me kod II.1.A me numër LN-0366-03-2020, datë 30/03/2020 me:*

Kategori: Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve ;

Nënkategori: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve ;

Veprimtari specifike: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz;

Emërtim përshkrues të veprimtarisë: Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz. (Ambalazhim i frutave dhe perimeve).

Sa më sipër, ashtu sic specifikohet edhe në licencën me numër LN-0366-03-2020 të dorëzuar nga shoqëria jonë, është një licencë e cila ka në fokusin e saj licencimin për veprimtarinë

specifike të “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila është praktikisht edhe licenca e kërkuar nga AK në dokumentet standarte të tenderit.

Në rastin konkret kërkojmë të theksojmë se kjo licencë jo vetëm që është e njëjtë me atë të kërkuar në dokumentet e tenderit por në vijim edhe të inspektimeve të kryera nga organet kompetente na rezulton se është licenca e nevojshme për të ushtruar veprimtari si ajo objekt ankimi, pra furnizimin me produkte ushqimore koloniale të ambalazuara/paketuara.

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orientuese e titullit të licencës dhe kërkesës” të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, në pikën 8 Emërtimi i veprimtarisë-ve specifike të licencuara sqarohet se: a) Këtu vendoset emërtimi i veprimtarisë specike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar të ushtrojë më shumë se një veprimtari specifike, këtu vendosen emërtimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen. c) Nëse këto shënime kërkojnë më shumë se 250 karaktere atëherë vihet shënimi: Për llojet e specifitimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....”

Sa më sipër, rezulton, se operatori ekonomik është i licencuar për veprimtari të ndryshme nga ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK është në kushtet e mospërbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Licencës së kategorisë II.1.A.1 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga verifikimi rezulton, se në Licencën II.1.A. me të cilën është pajisur ky operator ekonomik, veprimtarinë specifike të përshkruar në licencë e ka për fruta dhe perime, ndërkohë që objekti i prokurimit është ushqime koloniale. Gjykojmë, se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me licencat e kërkuara. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Sqarojmë, se kriteri për licencat duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjitha elementet e përcaktuara nga ligjvënësi si dhe të kërkuara dhe përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi, referuar mangësive të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të vërtetohet disponimi i licencës së kategorisë II.A.1, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave që përmban licenca, si dhe të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Ndërkohë KPP gjykon, se fakti që subjekti ka dorëzuar licenca të kategorisë II.1.A, jo domosdoshmërisht do të thotë që është përmbushur kriteri, pasi veprimtaria specifike ashtu sikurse është përcaktuar dhe në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: 1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj. 2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna ndër të tjera ç) ***llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj.*** Nga sa më sipër KPP gjykon, se licencimi i subjekteve kryhet për një veprimtari të caktuar të prodhimit, përpunimit, paketimit dhe shpërndarjes së ushqimeve. Në këtë kuptim pretendimi i

operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK nuk qëndron, pasi ky i fundit nuk arrin të provojë se disponon licencë II.1.A me fushë veprimtarie specifike prodhim, përpunim, e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, (ambalazhim paketim të produkteve koloniale si oriz, sheqer, fasule etj).

III.1.15. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon, se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parimin: a) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”*, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Nelsa” SHPK duhet të kishte dorëzuar licencën e kategorisë II.1.A për sa i përket veprimtarisë specifike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ku është cituar, se ***operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës.***

III.1.16. Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementesh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriteve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik “Nelsa”

SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Proinfini” SHPK në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.2.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.2.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.2.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.2.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë

prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-89077-11-24-2023, me objekt: “Loti IV– “Blerje artikuj ushqimor kolonial” me fond limit 54,521,956 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**

